

Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K

## STATUTI

I

### **SHOQERISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR "ORO BIANCO" SH.P.K.**

Bazuar në ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", (i ndryshuar) në ligjin 9723 datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit" (i ndryshuar), si dhe në Aktin e Themelimit të Shoqerisë "ORO BIANCO" SH.P.K, sot më datën 01 KORRIK 2020, ne ortakët :

**Rigels Hasan PURA** me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare, i identifikuar me "Nr. personal I50517115F, me datëlindje 17.05.1985, i lindur në Proptisht, Pogradec dhe banues në Pogradec,

**Markel Izia FRAHOLLI** me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare, i identifikuar me "Nr. personal I50819073V, me datëlindje 19.08.1985, i lindur dhe banues në Pogradec,

me Kontratën e Themelimit të datës 01 Korrik 2020 kanë themeluar Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K.

Sot më 01.07.2020 vendosëm të miratojmë e të depozitojmë në QKB Statutin për Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. të cilën e kemi hartuar dhe firmosur me këtë përbajtje:

#### **TITULLI I**

#### **EMERTIMI - SELIA - KOHEZGJATJA E AKTIVITETI DHE OBJEKTI DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Neni 1 Shoqëria tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar emërohet me emrin "ORO BIANCO" SH.P.K. Me këtë Statut në përputhje me Kontratën e Themelimit të Shoqerise "ORO BIANCO" SH.P.K bazuar në Legjislacionin Shqiptar në fuqi, ajo rregullon pozitën juridike të ortakëve dhe pozitën juridike e statusin e administratorit të shoqërisë. Me këtë Statut rregullohen të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të shoqërisë, të dhenat me rëndesi për pozitën dhe qëllimin juridik të saj, organizimi, aktiviteti financiar, objekti i veprimitarisë të shoqërisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e saj.

Neni 2 ORTAKET DHE MJETET FINANCIARE TE THEMELIMIT TE SHOQERISE

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. është krijuar nga ortakët e sipërpërmendur: **Rigels Hasan PURA** dhe **Markel Izia FRAHOLLI**. Burim i kapitalit fillestar të derdhur janë mjetet vetiake financiare pronë te tyre të cilat mund të shtohen gjatë vazhdimesisë së aktivitetit sipas mënyrave që parashikon ligji. Kjo shoqëri tregtare merr cilësinë si "Person Juridik" me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë "Qëndrës Kombëtare të Biznesit QKB". Shoqëria ka vulën dhe logon e saj identifikuase në formën dhe në ekstremitetet e caktuara nga asambleja e ortakëve.

Neni 3 SELIA E SHOQERISE

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. e ka selinë në rrëthin Pogradec në adresën: **"Ruga e Drilonit, me nr.pasurie 8/2/175, ZK 1298, Buçimas, Pogradec"**. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. ka të drejtë të operojë me filiale të vetat për qëllime tregtare, promocionale e marketing në të gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 4 KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

Kohezgjatja e veprimitarisë së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K do të jetë e pa kufizuar. Ky afat mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së ortakëve në pajtim me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

*Rigels B. Pura*

*Markel Izia FRAHOLLI*

Neni 5

## OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarisë së Shoqerisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K do të jetë:

-Bar Kafe; -Pub; -Disko; -Restorant; -Pastiçeri;- Hotel; -Shërbime të ndryshme ndaj publikut me transport brënda e jashtë vendit për udhëtarë dhe përmallra-Ngritje dhe përdorim i agjensive turistike, exchange-ve dhe i agjensive publicitare;

Të gjitha veprimtaritë e mësipërme do të realizohen në të drejtën e importit dhe eksportit komform kërkesave specifike të legjislacionit Shqiptar për secilën veprimitari.

## TITULLI II KAPITALI - INSTRUMENTAT E FINANCIMIT DHE PJESEMARRJA NE KAPITAL

Neni 6

### DISA TE DREJTA TE SHOQERISE

6.1 Objekti i veprimtarisë, Emertimi, Selia e Shoqërisë tregtare "ORO BIANCO" SH.P.K, Shtimi i ortakëve dhe ato çka janë percaktuar në këtë Statut mund të ndryshojnë me Vendim të Asamblesë së Ortakëve në perputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi.

6.2 Shoqëria tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K e ushtron veprimtarinë kryesore të saj në rrëthin e Pogradecit. Ajo mund të krijojë filiale, dege e perfaqësi brënda e jashtë vendit në përputhje me legjislacionin e sejçilit vend ku do të ushtrojë aktivitetin duke i shfrytezuar ato për aktivitet tregtar, për qëllime promocionale, marketingu dhe për aktivitete të tjera në varësi të kushteve dhe të rrëthanave në të cilat do të zhvillohet aktiviteti tregtar.

Neni 7

### QUELLIMI I AKTIVITETIT TE SHOQERISE

7.1 Shoqëria tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K ushtron veprimtarinë e saj për të realizuar fitimin.

7.2 Gjithë aktiviteti i saj bazohet duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, të sigurisë e të rentabilitetit dhe përgjigjet për detyrimet e veta me pasurinë e saj.

Neni 8

### MJETET E SHOQERISË

8.1 Kapitali Themeltar i Shoqërisë tregtare "ORO BIANCO" SH.P.K është 100.000 lek (njëqindmijë) lek. (Sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lek). Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë tregtare "ORO BIANCO" SH.P.K është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:

1. Rigels Hasan PURA është zotëruesh i një kuote me vlerë të përgjithshme në masën 51.000 (pesëdhjetëënjëmijë) lek e cila përbën 51% (pesëdhjetëënjëpërqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Markel Izia FRAHOLLI është zotëruesh i një kuote me vlerë të përgjithshme në masën 49.000 (dyzetenëntëmijë) lek e cila përbën 49% (dyzetenëntëpërqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Rigels R. Pura

E. M. T. E.

## Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K

Ky kapital në masën 100% do të jetë i derdhur tërësisht në bankë brënda 30 ditëve pas firmosjes së Statutit te Shoqerise Tregtare "ORO BIANCO" SH.P.K. Kuotat e pjesemarrjes në kapital janë të ndashme në rast suksedimi për shkak vdekjeje ose tjetërsimi. Në rast bashkepronesie të një pjesemarrjeje, të drejtat e bashkëpronarëve duhet të ushtrohen nga një përfaqesues, i mandatar, nga të gjithë të përfaqesuarit.

Neni 9

## ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

9.1

### Zmadhimi i kapitalit

Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin si me anën e derdhjeve në të holla, me anën e kapitalizimit të rezervave e të fitimeve neto të realizuara ashtu dhe me anën e futjes së "Aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra" në asetet e shoqërisë.

Zmadhimi i kapitalit me anën e derdhjeve të reja mund të realizohet vetëm nëpërmjet derdhjeve direkte në të holla në llogaritë e shoqërisë. Ai mund të zmadhohet nëpërmjet futjes në shoqëri të kontributive të natyrë duke respektuar rregullat e hipotekimit, të regjistrimit ose të dorëzimit komform kërkesave të standartëve të kontabilitetit, duke perjashtuar dorëzimet në shërbime.

Administratorit nuk i jepet e drejta të zmadhojë kapitalin, e drejtë kjo që disponohet vetëm nga ortakët në bazë të vendimit të "Asmblesë së ortakëve".

9.2

### Zvogëlimi i kapitalit.

Kapitali mund të zvogëlohet në rastet dhe menyrat e parashikuar në ligj me vendim të "Asamblesë së Ortakëve", vendim ky i marrë me maxhorancat e parashikuara për ndryshimet statutore. Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në te njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet "Audituesëve ligjorë, Ekspertë kontabël" në rast se ka të tillë të paktën 45 ditë përpëra mbledhjes së "Asamblesë së përgjithshme të ortakëve" të thirrur për të marrë vendim rrëth këtij projekti. "Audituesit ligjorë, Ekspertë kontabël" i bëjnë të ditur asamblesë vlerësimin e tyre për arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.

Secili nga ortakët në çdo rast ka te drejtën të marrë nga shoqëria kopje për të gjitha dokumentat që lidhn me shkaqet e zvogëlimit dhe me procedurën që do të zbatohet për zvogëlimin e kapitalit.

I gjithë informacioni bëhet i njobur për secilin ortak në harkun kohor nga data e thirrjes deri në datën e mbledhjes së "Asamblesë së përgjithshme të ortakëve" e cila merr vendim me specifika shumë të preçizuara, duke e miratuar me maxhorancat e parashikuara për ndryshimet statutore.

Neni 10

## KONTRIBUTE DHE FINANCIMET E ORTAKEVE

10.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K mund të marrë nga ortakët, me konsensusin paraprak të tyre, derdhje në kapital mbi bazën e një vendimi të "Asamblesë së përgjithëshme të ortakëve", duke nënshkruar me secilin nga ortakët, mbi bazën e konsultimeve personale, financime që shkaktojnë ndryshimin e raporteve në kuota për secilin Ortak në veçanti.

10.2 Gjithashtu Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K mund të marrë fonde nga ortakët në formë huaje ose me tjetër titull, me detyrimin e rimbursimit ose të pagesës së qerasë, duke zbatuar legjislacionin Shqiptar të mbledhjes së kursimeve prej ortakëve.

Neni 11

## NDALIMI I EMETIMIT TË TITUJVE TË DEBISË.

Shoqëria "ORO BIANCO" SH.P.K. nuk mund të emetojë tituj debie.

Rigjet Bojlla

AJF

Neni 12

## TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT

12.1 Pjesët e kapitalit janë të transmetueshme me anën e një akti (*inter vivos*)

12.2 Nëse një ortak kërkon të tjetërsojë titullin e pronësisë, te gjithin ose një pjesë të tij, do ti takojë secilit prej ortakëve të tjerë e drejta e parablerjes, me çmim e kushte të njëjtë. Me tjetësim do të kuptojmë transferimin e pronësisë dhe të çdo lloji të drejtë tjetër mbi koutën.

Këtu është e përfshirë e drejta e pronësisë në tërësi dhe uzufruki i pjesës së kapitalit; E drejta e parablerjes ka për objekt blerjen e të drejtës në fjalë që ortaku ka publikuar ta tjetërsojë.

12.3 Me qëllim ushtrimin e të drejtës së parablerjes, ortaku çedues (shitës) duhet të komunikohet me një letër rekomande "me njoftim marrje" ortakëve të tjerë, për kushtet e shitjes, çmimin dhe emrin e blerësit (të deklaruar të kuotave).

Po i njëjti njoftim duhet njëkohësisht, të realizohet me qëllim që të vihet në dijeni organi administrativ me letër rekomande me "njoftim të marrjes".

Ortakët e tjerë duhet të shprehin vullnetin për të ushtruar të drejtën e parablerjes po me letër rekomande me "njoftim marrje" e cila i dërgohet ortakut brënda tre muajve nga marrja e njoftimit të shitjes prej këtij të fundit. Vullneti i mësipërm duhet njëkohësisht të jetë manifestuar me qëllim të vëniec në dijeni të organit administrativ me letër rekomande "me njoftim marrjeje".

E drejta e parablerjes ushtrohet për të drejtën e mesipërme mbi të gjithë kuotën ose pjesë të saj të cilën ortaku ka ndërmend dhe e ka reklamuar ta shesë, me barazi në çmim dhe ne kushte të pa diferençuara përderisa ky operacion është objekt i propozimit të formuluar nga Ortaku ofertues.

Nëse më shumë se një ortak do të ushtrojë të drejtën e parablerjes, këta të fundit mund të bëhen blerës të kuotave të ofruara për shitje në proporcion me sasinë e kuotave të zotëruara nga secili prej tyre.

12.4 Në rast se transferimi i pjesëve do të kryhet duke mos zbatuar atë që është sipër shënuar, blerësi nuk do të ketë të drejtë të shënohet në librin e ortakëve, nuk do të legjitimohet në rast votimi dhe në të tjera të drejta administrimi dhe pasurore dhe nuk mund të tjetersojë pjesën e tij të kapitalit me efekt për shoqërinë.

12.5 Ndryshimi i pjesëmarrjes në kapital do të jetë i mundur pa mbikqyrjen e formaliteteve të mëposhtme në qoftë se ortaku (që ka kërkuar ndryshimet) ka përfituar tërheqjen nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes për këtë ndryshim specifik nga ana e të gjithë ortakëve të tjerë.

12.6 Ortakët që nuk manifestojnë vullnetin për blerje në terma dhe me mbikqyrjen e formaliteteve të sipërpërmendura do të thotë se heqin dorë nga ushtrimi i të drejtës së parablerjes: Kuota ndërkohë mund ti transferohet blerësit të treguar në deklaratë ose ortakëve që kanë ushtruar normalisht kërkesën për parablerje.

12.7 Transferimi i kuotave dhe regjistrimi i tyre duhet të kryhet brënda tre muajve nga skadencia e termave për ushtrimin e parablerjes. Kalimi i afatit pa ardhjen e njoftimeve të dorëheqjes nga parablerja do të bëjë të nevojshme të proçedohet me një deklaratë notieriale.

12.8 Pjesëmarrjet janë të transferueshme pa objekzionet e formaliteteve të lart përmendura pa ju takuar ortakëve e drejta e parablerjes, në rastin kur ndryshimi bëhet në favor të bashkëshortit të një ortaku ose të afermve të nje ortaku në çfarëdo mënyre.

Rigjetësore

AKF

**TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TRASHËGIMTA RËT OSE  
TEK ANËTARËT E FAMILJES**

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje mes bashkëshortëve.

**Neni 14 VOTAT E ORTAKËVE, LARGIMI I ORTAKUT, PËRJASHTIMI I ORTAKUT DHE  
PASOJAT QË SHKAKTOHEN NGA KËTO VEPRIME.**

14.1 Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (ne rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

14.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

14.3 Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

14.4 Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas formës së parashikuar nga ligji (ose në formën e zakonshme apo formën që mund te miratohet nga Administratorët):

14.5 Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjeter brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

14.6 Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*) sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

14.7 Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

14.8 Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.

14.9 Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij nenit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

14.10 Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Rigjet B. Para

SHKE

Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K

14.11 Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpérblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

14.12 Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kérkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpérblimin e dëmit të pësuar.

14.13 Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kérkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij nenit, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku:

- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut;
- ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

14.14 Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kérkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kérkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

14.15 Shoqëria ka të drejtë t'i kérkojë ortakut të përjashtuar shpérblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

14.16 Ortaku ka të drejtë t'i kérkojë shoqërisë shpérblimin e dëmit të pësuar, nëse kérkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

14.17 Ortaku nuk ka të drejtë t'i kérkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngrëndajt padi për shpérblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kérkuar nga shoqëria.

14.18 Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

14.19 Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

### TITULLI III

Neni 15

#### VENDIMET E ORTAKEVE

15.1 Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpérblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

Rigel B. Perai

[Signature]

- Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
  - j) shpërndarjen e fitimeve.

15.2 Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

15.3 Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilat nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

15.4 Çdo ortak i shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet e ortakëve dhe vota e tij ka vlerë në proporcion me pjesemarrjen e tij në kapitalin e shoqërisë.

Neni 16

## ASAMBLEJA E ORTAKEVE

16.1 Mbledhjet e asamblesë së ortakëve dhe mënyrat e komunikimit.

- a) "Asambleja e ortakëve" të shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. mund të mblidhet pranë selisë së shoqërisë ose në një tjetër vend, me kusht që ky të ndodhet brenda territorit Shqiptar.
- b) Njoftimi për mbledhje e "Asamblesë së përgjithëshme të ortakëve" kryhet me anen e letrave rekomande të dërguara ndaj ortakëve të paktën 15(pesëmbëdhjetë) ditë përpëra datës së mbledhjes. Letrat dërgohen rekomande me përgjigje në vendbanimin që rezulton në librat e ortakëve:
- c) Në rast të fundit njoftimi duhet të dërgohet në numrin e Telefonit ose Fa-xi që rezulton në Librat e Ortakeve; Ne mungesë të tij njoftimi nuk mund të kryhet me anën të Fax-it.
- d) Në njoftimin e mbledhjes duhet të parashikohet dita, vendi, ora e mbledhjes dhe çështjet e ditës për tu trajtuar. Kopje e njoftimit të bërë dorazi, e firmosur nga marresi dhe elementë të tjera lidhur me vërtetimin e marrjes kur njoftimi për mbledhje dhe komfirmimi i marrjes së tij nga sejciili ortak realizohen me Fax. Në këtë rast i gjithë dokumentacioni duhet të ruhen nga shoqeria në arkivën e saj.

16.2

### Telekomunikimi

Pjesemarrja në mbledhjen e asamblesë së ortakëve të shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. mund të kryhet edhe me anën e mjeteve të telekomunikimit, me kusht që pjesemarrësit të mund të identifikohen dhe ata të kenë mundësi të dëgjojnë debatet, të marrin apo transmetojnë dokumenta, të nderhyjnë kur dëshirojnë në çdo rast dhe në kohë reale në të gjitha çështjet që diskutohen duke diskutuar në debate për sejcilën nga çështjet që analizohen në mbledhje.

*Rigels Pura*



#### 16.3

##### Delegimi

- a). Ortaku mund të përfaqësohet në Asamble nga persona të veçantë të pajisur me prokurë të posaçme dhe dokumentacioni lidhur me të ruhet nga shoqeria. Prokura nuk mund të lëshohet me emrin e perfaquesuesit në të bardhë.
- b). Përfaquesuesi mund të zevendesohet vetëm me atë procedurë që saktësisht në mënyrë eksplikite është treguar në prokurë. Ai mund të jetë qoftë dhe jo ortak.
- c). Nëse prokura jepet vetem për një Asamble ka efekt edhe për mbledhjet e tjera të po të njëjtës asamble.
- d). Pranohet edhe prokura e përgjithshme e vlefshme për disa Asamble, pavarësisht nga çështjet e ditës. Përfaqësimi nuk mund ti jepet as administratorëve as revizorëve nëse ka të tillë të emeruar, as punonjësve të shoqërisë, as shoqërive të zotëruara nga shoqëria mëmë, apo anetarëve të organeve të administrimit, të kontrollit apo punonjësve të tyre.

#### 16.4

##### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave

Me përjashtim të rasteve kur parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Asambleja e ortakëve merr vendime me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve të pranishëm me përjashtim të vendimeve të parashikuara në pikat b),ë),gj),j të nenit 15.1, për të cilet është i nevojshem votimi pro i ortakëve që përfaqësojnë të paktën 3/4 e kapitalit të shoqërisë.

Për shkarkimin e administratorit mund të zbatohen rregullat e përcaktuara në nenin 95.6 të Ligjit "Per tregëtarët dhe shoqëritë tregëtarë".

Asambleja drejtohet nga administratori i vëtem ose nga "Presidenti i Këshillit të administrativ", ose ne rast të disa administratorëve me kompetenca të bashkuara apo të ndara dhe në këto raste drejtimi bëhet nga administratori më i vjetër dhe në mungese të personit të parashikuar nga pasuesi.

Asambleja mund të emerojë një sekretar qoftë edhe jo ortak dhe sipas nevojes vëzhgues qoftë dhe jo ortak.

Presidenti i asamblesë verifikon rregullsinë e situatës, vërteton identitetin dhe legitimimin e të pranishmëve, rregullon zhvillimin e asamblesë dhe vërteton rezultatet e votimit. Për zbatueshmërinë e këtyre proceseve duhet të bëhet vërtetim në procesverbalin e nënshkruar nga presidenti dhe nga sekretari (nëse ka të emëruar) ose nga noteri nëse kerkohet nga ligji.

Prosesverbal duhet të redaktohet menjehë nën kujdesin e Presidentit, ose në rastet e parashikuara nga ligji, nga administratorët apo nga noteri.

#### 16.5

##### Asambleja Totalitare

Në mungesë të komunikimit (njoftimit) formal, asambleja cilësohet si e mbledhur rregullisht, nëse në të marrin pjesë perfaquesuesit e të gjithë kapitalit të shoqërisë dhe të gjithë administratorët dhe

Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K  
ekspertët (nëse ka te emëruar), qofshin të pranishëm apo të njoftuar dhe asnjeri të mos dalë kundër trajtimit të çështjes.

Nëse administratorët apo ekspertët (nëse ka te emëruar), nuk marrin pjesë personalisht në asamble, duhet të leshojnë një deklaratë të posaçme me shkrim, e cila ruhet në aktet e shoqërisë, në të cilën duhet të deklarojnë që kanë dijeni për të gjitha çështjet e ditës dhe që nuk dalin kundër trajtimit të tyre.

## TITULLI IV

### ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

### ADMINISTRIMI

Neni 17

17.1 Administratorët kanë të gjitha kompetencat për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë për realizimin e objektit të shoqërisë, përjashto këtu kompetencat e atribuara vendimeve të ortakëve në bazë të ligjit, statutit dhe limiteve të përcaktuara nga akti i emërimit.

17.2 Emërimi i administratorëve është në kompetencë të "Asamblesë së ortakëve me jo më pak se 3/4 e votave të vlefshme".

117.3 Administratorët, të cilët mund të janë ortakë dhë jo ortakë, ***gëndrojnë në detyrë në rast revokimi ose dorëhëqjeje jo më tëpër se 5 vjet*** më të drejtën për tu rizgjedhur. Administratorët janë subjekte të ligjeve për ndalimin e konkurrencës.

17.4 Administrimi i shoqërisë tregtare "ORO BIANCO" SH.P.K. mund të realizohet:

- Nga një administrator i vetëm.
- Nga disa administratorë, nga 2 (dy) deri në 5 (pesë) sipas parashikimit të aktit të emërimit.

17.5 Në rast se administrimi i besohët më shumë se një personi, ortakët, me vendimin e emërimit do të vëndosin :

- Nëse po këto persona do të formojnë një Këshill Administrimi.
- Nëse administrimi i përket ,bashkarisht apo në mënyrë të veçuar, administratorëvë për kryerjen e veprimtarisë së rregullt të shoqërisë, apo bashkarisht ose në mënyrë të veçuar për kryerjen e administrimit të jashtëzakonshëm, përjashto këtu rastet ku në bazë të parashikimeve ligjore, statutore apo aktit të emërimit, administratorët duhet të vëndosin në formën e një organi kollegjial, në bazë kjo të nenit 17 " Pjesa e dytë" e po këtij statuti.

### Neni 18 ADMINISTRATORI. TË DREJTAT DHE DETYRAT Ë ADMINISTRATORIT

18.1 Administratori i Shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. do të jetë Z. Rigels Hasan Pura me Kombësi dhe Shtetësi Shqiptare, i identifikuar me "Nr. personal **I50517115F**, me datëlindje 17.05.1985 , i lindur në Proptisht, Pogradec dhe banues në Pogradec, **për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë riemërimi ose rizgjedhjeje nga "Asambleja e ortakëve"** i cili nuk ndalohet nga ligji, nuk ka konflikte interesit dëshiror që nuk është i lidhur në marrëdhënie të tjera në konceptin e personave të lidhur të cilat mund të prekin figurën e tij nga kërkesat e nenit 13 të ligjit "Për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë".

Detyrat konkrete që mund të kryhen prej administratorit të cilat janë të autorizuara nga asambleja e ortakëvë konkretisht janë:

- Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vëndosura nga asambleja e përgjithshme;
- Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

Rigels Pura

- ç) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.
- dh) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) Raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

18.2 Në mungesë apo pamundësi të ushtrimit të funksionit të Administratorit të, Shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. atë e zevëndëson një ortak ose një punonjës, që caktohet nga ai vetë me shkrim ose me prokurë të posaçme.

Neni . 19

#### KOMPENSIMI I ADMINISTRATOREVE

Administratorëve u takon rimbursim i shpenzimeve të kryera për shkak të detyrës së tyre. të vërtetuara me dokumentacion të rregullt dhe të ligjëshëm.

Po këtyre mund tu njihet në bazë të aktit të emërimit apo me një vendim të përbashëkt të ortakëve një shpërblim vjetor në masë fikse ose me perqindje në bazë fitimi.

Me vendim të "Asamblesë së ortakëve" mund tju jepet një kompensim vjetor si titull trajtimi për fond mandati në të njëjtën kohë duke kryer sigurimin e tyre për të garantuar dhënien e këtij kompесimi.

Neni.20

#### PERFAQESIMI I SHOQERISE

20.1 Përfaqësimi i përgjithshëm i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K, aktiv dhe pasiv substancial apo procedural. në rast emërimi të një administratori të vetëm i takon administratorit të vetëm.

Në rast emërimi të një këshilli administrimi , në bazë të vendimit të "Asamblesë së ortakëve" i adoptuar me të njëtin vendim emërimi përfaqësimi i shoqërisë bëhet nga:

- a) Presidenti nese ka të emëruar , zv/ presidenti nese ka të emëruar, administratorët apo prej administratorëve të deleguar, në limitet e kompetencave të përcaktuara nga "Asambleja e ortakëve". Kompetencat janë përcaktuar për seicilin person në aktin e emerimi dhe për delegimin e kompetencave.
- b) Të gjithë anetarët e këshillit të administrimit në menyrë të veçuar ose së bashku.
- c) Në rast emërimi të disa administratorëve me kopetenca të bashkuara apo të veçuara ( ne kuptim të nenit 17 "pjesa e dyte") përfaqësimi u takon po "Administratorëve" në mënyre të bashkuar apo të veçuar në rastin kur ata duhet të vendosin si "Organ Kolegjial".

Me vendime të posaçme e drejta e përfaqësimit realizohet prej seicilit Administrator në mënyrë të veçuar.

20.2 Akti i emërimit mund të parashikojë kufizime në kopetencat e përfaqësimit të administratorëve të parashikuara shprehimisht në aktin e emërimit.

Emërimi i drejtoreve ose përfaqësuesëve është e drejtë e organit administrativ me qëllim që në rast se janë në detyrë më shumë se një administrator në kuptim të nenit 17 "pjesa e dyte" , Ata do të vendosin me vendime të posaçëm si "Organ Kolegjial".

Për emërimin e përfaqësuesve të posaçëm vlejnë kopetencat e përcaktuara më siper për plotësimin e aktit specifik për të cilin lëshohet prokurë.

Rigels Blura

JFF

Neni . 21

## KONTROLLI I LLOGARIVE

"Asambleja e përgjithshme e ortakëve" e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. në kuptim të nenit të mësipërm mund të vendosi në çdo moment të emërojë një "Auditues Ligjor", duke i përcaktuar atij të drejtat kompetencat dhe detyrat e përgjithshme dhe specifike.

Neni. 22

## BILANCI DHE TE ARDHURAT

Viti ushtrimor hapet më datë 01 Janar dhe mbylljet më datën 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo viti ushtrimor organi administrativ realizon hartimin e bilancit të Shoqërisë sipas kërkesave të ligjit dhe në përputhje të plotë me strategjinë e përcaktuar dhe me detyrat e vendosura nga "Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve".

Bilanci i aktivitetit tregtar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. duhet t'ju paraqitet ortakëve për miratim nga "Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve" brënda njëqind e njëzet ditëve nga mbyllja e vitit kalendarik ushtrimor.

Neni. 23

## NDARJA E FITIMIT (DIVIDENTI)

Vendimi nga "Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve" të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. i cili e miraton bilancin përcakton edhe rregullat mbi ndarjen e fitimeve pas tërheqjes së një shume jo më të vogël e 5% (pesë përqind) për rezervën ligjore deri sa kjo të arrijë limitin ligjor.

Fitimet do t'ju ndahen ortakëve bazuar në kuotat e pjesëmarrjes në kapitalin e derdhur të shoqërisë, me përashtim të ndonjë vendimi tjeter të marrë nga "Asambleja e përgjithshme e ortakëve" që parashikon krijimin e një foni rezervash të jashtëzakonshëme, ose destinon tjeter destinacion.

Fitimet neto mund të mbeten të pashpérndara duke i mbartur të gjitha ose një pjesë të tyre për vitin tjeter financiar.

Pas përballimit të detyrave për likujdimin e furnitorëve, taksave, tatimeve, pagave të punonjësve dhe shpenzimeve të tjera, që ka Shoqëria tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K, fitimi neto i Shoqërisë i perket "ortakëve" të Shoqërisë në masën 100% për të cilin në vitin pasardhës me vendim të posaçëm të "Asamblese së ortakëve" brënda gjashtë mujorit të parë përcaktohet destinacioni i përdorimit të tij.

## TITULLI V MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PËRGJEGJËSIA

Neni 24

## MARRËDHËNIET E PUNËS

**24.1** Marrëdhëniet e punës brënda Shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K rregullohen në përputhje me Aktin e Themelimit, me këtë Statut dhe duke u bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Shoqëria lidh kontrata përmarrjen në punë të punonjësve sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë dhe i trajton punonjësit duke respektuar tëresisht legjislacionin që lidhet me të drejtat e punonjësve dhe detyrimet e shoqërisë ndaj tyre duke njojur reciprokisht përgjegjësitë e ndërsjellta të palëve "Punëdhënës, punëmarrës"

**24.2** Çdo punonjës në Shoqërinë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. është përgjegjës përmirësuar me profesionalizëm dhe disiplinë të punës. Ortakët, Administratorja dhe punonjësit e Shoqërisë janë të detyruar të ruajnë karakterin e fshehtë të dokumentacionit, të informacionit dhe burimet e tij, të njojurive e të përvojës së fituar e të shkëmbyer në këtë shoqëri

Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K

tregëtare, të ruajnë fshehtesinë e gjëndjes financiare, të depozitave e të dhëna të tjera që organi drejtues i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. i konsideron sekrete të punës.

24.3 Të dhënat që paraqesin sekrete të punës mund tu bëhen të njohura personave të tjera me lejën e Administratorit të Shoqërisë.

Detyrimi për ruajtjen e sekretit vazhdon edhe pas nderprerjes së marrëdhënieve të punës me Shoqerinë duke qënë detyrim sipas përcaktimeve të shprehura në "Kodin e punës së Republikës së Shqipërisë" dhe në kontratën individuale apo kolektive të punës.

## TITULLI VI MBYLLJA E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### Neni 25 KUSHTET DHE PROCEDURAT E MBYLLJES SË SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

25.1 Në qoftë se humbjet e Shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K nuk mund të përballohen me mjetet materiale e financiare të Ortakëve atëherë hapet procedura e likujdimit. Në rast se kapitali i derdhur në themelimin e Shoqërisë, fitimet e akumuluara më pas gjatë veprimtarisë së saj dhe fondet materjale e financiare nuk perballojnë shpenzimet, atëherë hapet "procedura e likujdimit të Shoqerise" me vendim të jashtëzakonshëm të "Asamblesë së Ortakëve" ose procedura e falimentimit të saj me vendim të "Gjykatës së Qarkut" ku ndodhet selia kryesore e shoqërisë.

25.2 Shoqëria tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. mund të shpërndahet me likujdimin e saj. Ne rastin e likujdimit të Shoqërisë emertimi i saj do të pasohet nga shënim "Shoqëria në likujdim e sipër". Në rast shpërndarje të Shoqërisë, Administratori ose (Administratorët) vendosin për mënyrën e likujdimit, ndërsa "Asambleja e ortakëve" cakton një ose disa likujdatorë, të cilët bëjne kujdes që Shoqeria të likujdojë detyrimet që ka ndaj personave të tretë.

25.3 Kur Shoqëria tregtare pushon aktivitetin e saj, pasi shlyen detyrimet që ka, pjesa e mbetur e kapitalit dhe të ardhurat i mbeten ortakëve sipas raportit të kontributit në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë.

25.4 Ndarjet individuale destinoohen në bazë të vendimit të jashtëzakonshëm të hartuar mbi të dhënat e raportit të likujdimit të hartuar nga "likujdatori ose grupi i likujdatorëve".

25.5 Veprimtaria ekonomiko-financiare e Shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. mbylljet më 31 Dhjetor të çdo viti. Bilanci vjetor i Shoqërisë duhet të shqyrtohet dhe miratohet nga "Asambleja e ortakeve" brënda muajit Mars të vitit pasardhës.

## TITULLI VII DISPOZITA TE FUNDIT

### Neni 26 DEKLARIMI I KRIJIMIT TE SHOQERISE

26.1 Kjo shoqëri tregtare merr cilësinë si "Person Juridik" me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë "Qëndrës Kombëtare të Biznesit QKB". Ky Statut i shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K nënkuption se kjo shoqëri tregtare është deklaruar e krijuar me regjistrimin e saj në "Regjistrin Tregtar". Më pas të dhënat e tjera të saj deklarohen në mënyrë sistematike në vazhdimësinë e aktivitetit tregtar komform kërkësave të ligjeve të veçantë dhe kështu ato janë të transferuara dhe të deklaruara në "Qëndren Kombëtare të Regjistrimit të Bizneseve QKB"

Statuti i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K

Përfundimisht shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. konsiderohet e krijuar nga dita kur ajo ka fituar statusin e Personit Juridik.

26.2 Ndryshimet në këte Statut të Shoqërisë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. bëhen në te njëjtën menyrë e me të njëjtën procedurë me të cilën nxirret ky Statut duke zbatuar Dispozitat Ligjore përkatese.

#### Neni .27 ADRESAT E ORTAKËVE DHE ADMINISTRATORËVE

27.1 Për qëllim të kësaj marrëveshje shoqërore, të gjitha komunikimet direkte për çdo ortak dhe për çdo administrator do të kryhen duke përdorur adresat e secilit ortak dhe të secilit administrator që rezultojnë respektivisht tek libri i regjistrimit të ortakëve dhe tek libri i vendimeve të administratorëve.

27.2 Në librin e ortakëve dhe në atë të vendimeve të administratorëve duhet të jenë respektivisht të treguara adresat e komunikimit, numri i telefonit, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike (e-mail).

27.3 Çdo modifikim i mëvonshëm i të dhënave të adresës kryesore në kuptim të këtij neni do të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim tek administratorët të cilët do ta pasqyrojnë në librin e ortakëve ose në librin e vendimeve të administratorëve.

27.4 Mbetet detyrë e çdo ortaku dhe administratori përgjegjesia për mungesën e komunikimit dhe për modifikimet e nevojshme të kërkua e paragrafet e mësiperme të kësaj dispozite.

#### Neni 28 KLAUZOLA TË KOMPROMISIT

28.1 Të gjitha mosmarreveshjet që mund te lindin ndërmjet ortakëve, si dhe ndërmejet ortakëve dhe shoqërisë "ORO BIANCO" SH.P.K. në lidhje me raportet shoqerore ose për intrepretimin dhe zbatimin e këtij statuti dhe të vendimeve ligjërisht të nxjerra nga "organet e shoqërise", "nga ato të emëruara prej Asamblesë së ortakëve" dhe nga administratorët, likuidatorët dhe titullarët ose në raportet me ta, për sa janë shtruar për kompromis, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe kur ato nuk gjejnë zgjidhjen e pranuar, do ti paraqiten Gjykatës në rrëthin në të cilin shoqëria ka Selinë.

28.2 Kur mirëkuptimi me kompromise nuk arrihet pavarësisht nga negociatat e realizuara midis palëve atehere të gjitha mosmarrveshjet do të zgjidhen nëpërmjet Gjykatës së Rrethit gjyqësor ku Shoqëria tregtëare me Përgjegjësi të Kufizuar "ORO BIANCO" SH.P.K. ka selinë saj.

#### Neni 29 REFERIMET

Për sa nuk është shprehimisht përcaktuar në këtë statut, vlejnë dispozitat e ligjit 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe të ligjeve të posaçme të fushës së aktivitetit tregtar.

#### ORTAKËT THEMELUES

Rigels Hasan PURA

Markel Izia FRAHOLLI